

01-557

	Republika e Kosovës Republika Kosova – Republic of Kosovo Komuna e Prishtinës Opština Priština –Municipality of Prishtina	PRISHTINA 
---	---	--

Në bazë të nenit 21, 22 dhe 44 të Ligjit Nr. 05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës nr. 20/21 qershor 2016), nenit 27 dhe 28 të Ligjit Nr. 04/L-110 për Ndërtim (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës nr. 18/03 korrik 2012), nenit 17 pika “d” e Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr. 03/L-040 dt.20.02.2008, nenit 15 pika “d” e Statutit të Komunës së Prishtinës Nr.110-391 dt. 25.02.2010, dispozitave të nenit 12 të Udhëzimit Administrativ MMPH Nr. 05/2017 për mbikëqyrje inspektuese dhe procedurën për lëshimin e certifikatës së përdorimit, dhe duke vendosur sipas kërkesës 05 Nr. 391/02-47329/25 dt. 04.04.2023, të pronarit Ekrem Fazliu nga Prishtina, rruga “Ksamili”, nr26, Lagja Sofali, për lëshimin e certifikatës së përdorimit, për ndërtesën shtëpi banimi individual, ndërtuar në bllokun “F03” të tërësisë “F” të Planit Rregullues të Hollësishëm “Sofalia”, në Prishtinë, Drejtoria e Urbanizmit dhe Mjedisit e Komunës së Prishtinës, në procedurë të rregullt administrative, me datë 14.05.2024, lëshon këtë:

CERTIFIKATË E PËRDORIMIT

I. I LEJOHET pronarit Ekrem Fazliu nga Prishtina, sipas kërkesës 05 Nr. 391/02-47329/25 dt. 04.04.2023, përdorimi i ndërtesës shtëpi banimi individual, me etazhitet S+P+1ET, e ndërtuar sipas Vendimit të Lejes Ndërtimore 05 Nr. 351/02-165565/21 dt. 24.01.2022, në kuadër të bllokut urban “F03” të tërësisë “F” të Planit Rregullues të Hollësishëm “Sofalia” në lagjen Sofali, Prishtinë konkretisht në parcelën kadastrale nr. 94-9, ZK. Sofali.

II. Ndërtesa nga pika I. e këtij vendimi, ndodhet në rrugën “Ksamili”, ku ka dalje hyrjen ndërtesa me numër: 26 në Prishtinë, dhe të njëjta do të përdoret dhe shfrytëzohet sipas destinimit të caktuar me leje ndërtimi dhe dokumentacionin ndërtimor, nga dita e marrjes në dorëzim të këtij vendimi të certifikatës së përdorimit.

III. Kjo Certifikatë do të shërbejë si bazë për regjistrimin e ndërtesës në evidencat e regjistrit kadastral.

IV. Pjesë përbërëse e këtij vendimi të certifikatës së përdorimit është dokumentacioni sipas Shtojca 5 e Udhëzimit Administrativ MMPH Nr. 05/2017 për mbikëqyrje inspektuese dhe procedurën për lëshimin e certifikatës së përdorimit.

A r s y e t i m

Pronari Ekrem Fazliu nga Prishtina, me kërkesën me 05 Nr. 391/02-47329/25 dt. 04.04.2023, i është drejtuar kësaj Drejtorie, për lëshimin e certifikatës së përdorimit për ndërtesën shtëpi banimi individual, me etazhitet S+P+1ET, të ndërtuar në kuadër të bllokut urban “F03” të tërësisë “F” të Planit Rregullues të Hollësishëm “Sofalia” në lagjen Sofali, Prishtinë, konkretisht në kuadër të parcelës kadastrale nr. 94-9, ZK. Sofali, sipas Vendimit të Lejes Ndërtimore 05 Nr. 351/02-165565/21 dt. 24.01.2022, të lëshuar nga Drejtoria e Urbanizmit e Komunës së Prishtinës.

Paraprakisht Drejtoria e Inspeksionit-Sektori i Ndërtimit i Komunës së Prishtinës, përmes shkresave zyrtare “Akt përcjellës”, me referencë 09 Nr. 391/02-24302/25 dt. 04.04.2025, ka përcjellë në Drejtorinë e Urbanizimit, Raportet e Njoftimit mbi Inspektimit Final të punëve dhe përshkrimit të dokumentacionit, hartuar nga ekipi profesional i Drejtorisë së Inspeksionit të Komunës së Prishtinës.

Me kërkesë, kërkesit kanë prezantuar dokumentacionin sipas Shtojca 5 të e Udhëzimit Administrativ MMPH Nr. 05/2017 për mbikëqyrje inspektuese dhe procedurën për lëshimin e certifikatës së përdorimit: Lista kontrolluese e Protokollit të Inspektimit/1.Inspektimi i themelit; Lista kontrolluese e Protokollit të Inspektimit/2.a.1.Inspektimi i pjesëve strukturore-Strukturave të betonit para instalimit të derdhjes; Lista kontrolluese e Protokollit të Inspektimit/2.a.2.Inspektimi i pjesëve strukturore-Strukturat e betonit; Lista kontrolluese e Protokollit të Inspektimit/2.c.Inspektimi i pjesëve strukturore-Strukturat e çelikut; Lista kontrolluese e Protokollit të Inspektimit/2.d.Inspektimi i pjesëve strukturore-Strukturat e drurit; Lista kontrolluese e Protokollit të Inspektimit/3.Inspektimi i instalimit elektrik; Lista kontrolluese e Protokollit të Inspektimit/4.Inspektimi i instalimeve të ujit; Fotografi gjatë procesit të ndërtimit; Dëshminë mbi pagesën e lejes ndërtimore; Atestet e materialeve dhe rezultatet e testimeve, certifikatat; Raportin e përfundimit të punëve të ndërtesës, nga udhëheqësi i vend ndërtimit Bledi Lipovica; Raportin e përfundimit të punëve të arkitekturës, nga mbikëqyrësi Bledi Lipovica; Raportin e përfundimit të punëve të konstruksionit, nga mbikëqyrësi Herloinde Dautaj; Raportin e përfundimit të punëve të instalimeve të ujësjellësit dhe kanalizimit, nga mbikëqyrësi Besart Osmanaj ; Raportin e përfundimit të punëve të instalimeve elektrike, nga mbikëqyrësi Berat Hasanaj; Incizimin gjeodezik të objektit, dhe rregullimit të jashtëm-gjendjen e realizuar, me vijën rregullative dhe vijën ndërtimore e vendosur në sistemin koordinativ sipas Kosovaref 01, nga gjeodeti i licencuar për kryerjen e matjeve kadastrale Faton Bajselmani me nr. të licencës 125;

Kjo drejtori, pas shqyrtimit të kërkesës, provave të lëndës, mendimit profesional të organit kompetent, Raportet e përfundimit të punëve, sipas fazave, dhe Raportin e Inspektimit Final, ka konstatuar se:

Në raportet përfundimtare të inxhinierëve të fazave të ndërtimit: arkitekturë, strukturë, instalimet e ujësjellësit dhe kanalizimit, instalimet elektrike, konstatohet se punët janë zhvilluar në harmoni me dokumentacionin ndërtimor/projektin kryesor, si dhe me normat dhe standardet në fuqi, gjegjësisht ndërtesa shtëpi banimi individual mund të përdoret.

Bazuar në nenin 27 dhe 28 të Ligjit Nr. 04/L-110 për Ndërtim dhe dispozitat e nenit 12 të Udhëzimit Administrativ MMPH Nr. 05/2017 për mbikëqyrje inspektuese dhe procedurën për lëshimin e certifikatës së përdorimit, ku thuhet se lëshimi i certifikatës së përdorimit mund të bëhet nëse kërkesat nga Ligji për Ndërtim nr. 04/L-110, janë plotësuar, organi kompetent lëshon certifikatën e përdorimit brenda kohës së caktuar.

Andaj, bazuar në konstatimet e mësipërme dhe në raportet e prezantuara-bashkangjitura në kërkesë, kjo drejtori konstatoi që ndërtesa shtëpi banimi individual mund të përdoret, gjegjësisht vendosi të lëshojë certifikatën e përdorimit për ndërtesën shtëpi e banimit individual.

Bazuar në konstatimet e më sipërme u vendos si në dispozitiv të kësaj Certificate.

Udhëzimi juridik: Pala e pakënaqur me këtë Certifikatë, me ankesë mund ti drejtohet kësaj drejtorie brenda afatit prej 30 ditësh, duke llogaritur nga dita e marrjes në dorëzim të kësaj Certificate. Bazuar në vlerësimin nga kjo drejtori, ankesa do të shqyrtohet apo do të përcillet te organi epror – MMPHI-ja

Ky vendim u printua në 6 (gjashtë) kopje identike dhe i dërgohet: Kërkuesit/Investitorit, Drejtorisë së Kadastrit, Drejtorisë së Inspeksionit, kësaj drejtorie, Qendrës për shërbim me qytetarë dhe në dosje të lëndës.

**DREJTORIA E URBANIZMIT DHE MJEDISIT E KOMUNËS SË PRISHTINËS,
05 NR. 391/02-47329/25 DT. 14.05.2025**

Zyrtari,
Berim Osmanaj



Udhëheqëse e Sektorit,
Nazife Krasniqi



